

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Raporti i Progresit 2009 - sfidat

6 Nëntor 2009

Raportit i Progresit 2009

“Përkushtimi i Qeverisë drejt integrimit në BE duhet të përmirësohet dukshëm”¹


Raporti i Progresit 2009 nga Komisioni Evropian është vlerësuar në mënyra të ndryshme nga klasa politike. Përderisa opozita e ka quajtur raport të regresit, pozita e ka vlerësuar si raport historik. Raporti vlerëson se Kosova në të vërtetë ka bërë shumë pak progres prej vitit të kaluar deri në Shtatorin e vitit 2009, kurse në disa fusha, gjendja madje është përkeqësuar. Me qëllim të përmirësimit të debateve publike në lidhje me raportin e progresit, Instituti GAP në këtë shkrim paraqet një informatë të shkurtër mbi progresin në vitet e kaluara, dhe sfidat kryesore.

Përbledhje e progresit të Kosovës

Kriteret Politike

Në vitin 2006, Kosova kishte bërë progres të mirë në përbushjen e obligimeve të saj ndërkombëtare dhe atyre regionale, por që nga atëherë, progresi ka ndaluar. Në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, situata në Kosovë është përkeqësuar që nga viti 2007. Progresi në mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe minoriteteve ka qenë i çrregullt kurse prej vitit 2009 situata është përkeqësuar. Raporti i Progresit nënvízon problemet rreth implementimit të ligjit, pavarësisë së institucioneve nga influenca e tepruar e Qeverisë, dhe kapaciteti i dobët brenda institucioneve.

Progresi në kriteret politike




Kriteret Ekonomike

Kapaciteti i Kosovës për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe fuqisë së tregut që do të thotë mundësitet e saj për të funksionuar brenda ekonomisë së BE-së ka shënuar vetëm pak progres krahasuar me katër Raportet e kaluara të Progresit. Më seriozisht, themelimi i

një tregu ekonomik funksional ka shënuar vazhdimisht më pak progres me kalimin e viteve. Në vitin 2009, jo balancimi i madh tregtar, largimi prej privatizimit drejt investimeve kapitale si stimulues për rritje ekonomike (duke përfshirë ‘zhvillime shqetësuese’ në fushën e prokurimit publik) dhe niveli i lartë i papunësisë sidomos i atijë të rinisë, e kanë zbehur edhe më shumë progresin ekonomik të Kosovës.


Progresi në kriteret ekonomike



Kriteret e standardeve evropiane

Në fushën e standardeve evropiane, që do të thotë zotësia e Kosovës për të implementuar *acquis communautaire*, Kosova ka bërë ca progres në dy vitet e kaluara. Megjithatë, nëse shikohet nga një vështrim më afatgjatë, Kosovës ende i duhet të bëjë që të barazohet me nivelin e progresit të saj të vitit 2006.

Progresi në standarde europiane



Fushat ku progresi mungon më së shumti

Në Raportin e Progresit 2009 ka shumë tema që ndërlidhen me kriteret e ndryshme në bazë të të cilave Komisioni Evropian gjykon progresin e Kosovës drejt integrimeve në BE. Më poshtë janë disa citate nga Raporti i Progresit, të grupuara në disa fusha të përbashkëta.

Mbikëqyrja e dobët

Organet mbikëqyrëse – prej kuvendit deri tek institucionet e pavarura rregullative të medieve – nuk po kryejnë obligimet e tyre për të vënë në llogari ekzekutivin. Kjo dëmton jo vetëm demokracinë, por edhe ekonominë.

‘Mbikëqyrja e degës së ekzekutivit nga kuvendi ka nevojë për përmirësimë të mëtejme’² dhe ‘mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë Kosovare duhet të forcohet’³. ‘Fuqia e mekanizmave mbikëqyrës (e partive politike) dhe mungesa e transparencës në lidhje me financimin e partive politike mbetet problem shqetësues’⁴. ‘Pavarësia dhe paanshmëria e...RTK-së nuk është e siguruar sa duhet...(dhe) në përgjithësi, liria e shprehjes nuk është e garantuar tërësisht...Rastet e kërcënimeve politike kërkojnë masa më të forta nga autoritetet Kosovare’⁵. ‘Implementimi i ligjit mbi RTK-në si dhe emërimi i bordit të ri të RTK-së mbetet çështja më serioze shqetësuese’ në fushën e zhvillimit të medieve dhe informacionit në shoqërinë Kosovare.⁶ ‘Mbikëqyrja e sektorit privat dhe sidomos e sektorit të patundshmërisë duhet adresuar urgjentisht.’⁷

Kapacitetet e varfra për implementim

Institucionet dhe agjencitë e Qeverisë nuk e bëjnë punën e tyre, madje edhe aty ku ligjet ekzistojnë dhe lejojnë për ta bërë këtë. Pa kapacite më të forta në këto institucione, Kosova nuk mund të shpresojë të zhvillohet si shtet demokratik dhe efektiv.

Kapaciteti i institucioneve evropiane është i dobët, kurse situata në sektorin ligjor, i cili është ‘i dobët, i lëkundshëm ndaj ndërhyrjeve politike dhe joefektiv,’⁸ kërkon vëmendje urgjente. Agjencia për koordinimin e zhvillimeve dhe integrimeve evropiane kërkon ‘ngritje të mbështetjes së nivelit të lartë politikë për të kryer punën e saj’ përfshirë këtu edhe fokusimin në implementimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian.⁹ ‘Legjislacioni për punë është implementuar në mënyrë të varfër dhe mbetet i dobët’¹⁰ dhe përderisa ‘sistemi institucional dhe ligjor është përforcuar’ në fushën e të drejtës mbi pronë, kjo ka quar në ‘progres të limituar në praktikë.’¹¹ ‘Administrimi publik ka kapacitet të pa mjaftueshëm’ për një menaxhim modern publik finanziar.¹² ‘Kapaciteti administrativ për të implementuar (standardet evropiane dhe ligjin në fushën e qarkullimit të lirë të mallrave) është jo adekuat. Përpjekje të konsiderueshme duhen edhe më tej në këtë aspekt’.¹³ ‘Kapaciteti i autoritetetve të legjislacionit dhe forcimit të ligjit për t'u ballafaquar me shpërlarjen e parasë nuk ka shënuar ndonjë progres’¹⁴. ‘Kosova ka nisur procese për të adresuar prioritetet (në fushën e policisë). Megjithatë, urgjentisht një numër i deficiteteve të tjera duhet adresuar’.¹⁵

Ndërhyrjet politike

Raporti citon ‘ndërhyrjet politike’ në shumë raste ku është krejtësisht pa vend.

Ekziston ndërhyrje politike në sektorin gjyqësor¹⁶; ‘ka pasur raste të ndërhyrjeve politike në emërimë në pozita kyçe të shërbyesve civil (duke përfshirë pozita civile të seniorëve brenda ministritive, në bordet e ndërmarrjeve publike, në zyrën e Ombudspersonit, Gjykatën Kushtetuese’.¹⁷ Pavarësia e autoritetave për të rregulluar industritë e mëdha ‘është zbehur nga ndërhyrjet politike në bordet e tyre’.¹⁸

Korrupsioni

Korrupsioni, një fenomen ky i ndërlidhur me mos sundimin e ligjit, mbikëqyrjes së varfér të qeverisë dhe ndërhyrjeve në emërimë në pozita kyçe, duket se po bëhet edhe më keq. Kjo dëmon ton demokracinë dhe zhvillimin ekonomik.

‘Korrupsioni mbeten i përhapur në shumë fusha në Kosovë dhe vazhdon të mbeten një çështje shume shqetësuese’¹⁹. ‘Dyshimet rreth korruptionit dhe keqpërdorimeve në sistemin gjyqësor, akoma nuk janë hetuar si duhet’²⁰. ‘Sundimi i dobët i ligjit ka vazhduar të jetë një pengesë madhore në zhvillimet socio-ekonomike’²¹ dhe në përgjithësi, ‘administrimi i dobët dhe sundimi i ligjit, furnizimi jo stabil me rrymë, qasja e limituar në financa, korruptioni dhe të drejtat pronësore të definuara dobët...vështirësojnë hyrjen dhe daljen në treg’²² dhe vazhdojnë ‘të dobësojnë efikasitetin e mekanizmave të tregut’²³. Korrupsioni ‘është një shqetësim në fushën e doganave’ kurse ‘lufta ndaj korruptionit duhet të intensifikohet’²⁴. ‘Licencat për të fluturuar në dhe prej Prishtinës lëshohen në mënyrë jo-transparente dhe me vonesa të pa arsyeshme’ përderisa ka pasur edhe ‘zhvillime shqetësuese në fushën e aviacionit’.²⁵

Prokurimi publik

‘Situata rreth prokurimit është keqësuar krahasuar me vitin paraprak’ dhe ‘implementimi i ligjit (mbi Prokurimin Publik) në praktik ngre shqetësimë serioze’²⁶. ‘Zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbeten të luhatshëm karshi ndërhyrjeve dhe kërcënimëve’ gjë që ka ‘një ndikim negativ në kualitetin e prokurimit publik’²⁷. ‘Përdorimi i tenderit me një burim është rritur prej 50 milion euro në 164 milion euro,’²⁸ që do të thotë se 164 milion euro e parasë pubike i është dhënë kompanive pa asnjë garë.

Mungesa e strategjisë ekonomike

Vështirësita ekonomike të Kosovës janë përkeqësuar si pasojë e mungesës së mendimit strategjik dhe afatgjatë në këtë fushë.

Ekziston një “kualitet i dobët i planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor” që do të thotë se “Kosova ende duhet të punojë në marrjen e përgjegjësisë së plotë mbi stabilitetin makro-ekonomik”.²⁹ Zhvillimi ekonomik vazhdimisht ndikohet nga shpenzimet qeveritare: investimet publike janë rritur për 194% mirëpo investimet private kanë shënuar rënje prej 10.2%.³⁰ Deficiti tregtar i Kosovës po vazhdon të zgjerohet: shuma e eksporteve totale të Kosovës po rritet shumë ngadalë, në 5.3% të bruto produktit vendor. Në anën tjetër, importet janë rritur në 50.2% të BPV-së.³¹ “Sikurse edhe në vitet e mëparshme, bilanci përfundimtar në llogarinë kapitale dhe financiare ishte më i ulët se sa deficiti në llogarinë rrjedhëse, duke lënë kështu një pjesë të financave të pashpjegueshme”.³² Enti Statistikor i Kosovës “ende nuk është në gjendje të nxjerrë statistika të mjaftueshme ekonomike për të

përforuar procesin e politik-bërjes".³³ Përderisa të dhënat statistikore janë të pasigurta, papunësia vazhdon të mbetet jashtëzakonisht e lartë, diku rreth 40%.³⁴ Ndërsa papunësia tek të rinxjtë është edhe më e lartë,³⁵ dhe "për shumë të rinj, emigrimi dhe punësimi jashtë vendit ngelet mundësia e vetme për t'i përkrahur familjet e tyre në Kosovë";³⁶ "Shumë pak është bërë në zhvillimin e mëtutjeshëm të potencialit ekonomik te të rinjve në Kosovë"³⁷. "Në përgjithësi, baza teknologjike dhe gjendja e infrastrukturës fizike mbresin të dobëta, ndërsa kapitali i njerëzve të kualifikuar është ende i vogël. Si rezultat i kësaj, kompanitë kosovare janë shumë rrallë konkurrente edhe në ata sektorë ku ekziston potencial konkurrues në treg."³⁸

Vizat

Kosova është shumë larg anëtarësimit në Schengen Listën e Bardhë të BE-së.

"Kosova është tek në fillim të adresimit të prioriteteve të saj sa i përket politikave rreth vizave, kufijve dhe menaxhimit të tyre. Kosova do të duhej të fillonte zhvillimin e një politike koherente për viza në përputhshmëri të plotë me standartet evropiane."³⁹

Krimi i organizuar

Zhvillimet në fushën e krimit të organizuar në Kosovë janë tejet shqetësuese.

"Është arritur shumë pak progres në luftimin e krimit të organizuar, që paraqet një çështje vërtet shqetësuese, sidomos në pjesën veriore të Kosovës dhe në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë".⁴⁰ "Kosova nuk ka ndonjë strategji për zvogëlimin e krimit. Kosova ka mungesë të resurseve të nevojshme për ta luftuar këtë fenomen në mënyrë efektive".⁴¹ "Shpërlarja e parave gjithashtu mbetët një tjetër çështje shqetësuese".⁴² "Luftimi i krimit financiar është një ndër prioritetet kyçë të Partneritetit Evropian. Mirëpo, Kosova ka ndërmarr vetëm disa hapa të vegjël në adresimin e këtij fenomeni në mënyrë efektive... Korniza legislative duhet të fuqizohet më shumë për të siguruar definimin e shpërlarjes së pareve si krim; Në të ardhmen, njësia Kosovare e inteligencës financiare duhet të jetë e pavarur nga ndikimet e ndryshme politike dhe të tjera, si dhe të gjitha aktet tjera ligjore dhe nënligjore duhet tëjenë në përputhshmëri të plotë me standartet evropiane."⁴³

Shtojca: Përmledhje e katër Raporteve të fundit të Progresit

Fushat			2006	2007	2008	2009
Politike	Democracia dhe sundimi i ligjit	Kuvendi				
		Qeveria				
		Administrata Publike				
		Gjykatat				
		Politikat kundër-korrupsion				
	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave	Mbikqyrja e ligjit ndërkombe tar mbi të drejtat e njeriut	Nuk ka			
		Të drejtat civile dhe politike				
		Të drejtat ekonomike dhe shoqërore				
		Të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore, mbrojtja e pakicave				
	Çështjet rregullative dhe obligimet ndërkombe tare					
Econome	Funksionimi i ekonomisë së tregut	Politikat e domosdoshme ekonomike				
		Stabiliteti makroekonomik				
		Ndërlidhja e forcave të tregut				
		Hyrja në treg dhe dalja nga tregu				
		Sistemi ligor				
		Zhvillimi i sektorit finansiar				
	Kapaciteti për tu përballur me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut	Ekzistenza e funksionimit të ekonomisë së tregut				
		Kapitali njerëzor dhe fizik				
		Struktura sektoriale dhe e ndërmarrësisë				
		Ndikimi i shtetit/qeverisë mbi konkurrencën				
Standartet evropiane	Tregu i brendshëm	Inegrimi ekonomik dhe përshtatja me atë të BE-së	Nuk ka			
		Lëvizja e lirë e mallrave				
		Lëvizja e njerëzve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit				
		Lëvizja e lirë e kapitalit				
		Doganat				
		Tatimet				
		Konkurenca				
		Prokurimi publik				
		Ligi mbi të drejtën e autorësisë				
		Politikat e punësimit dhe politikat shoqërore				
	Politikat sektoriale	Arsimi dhe hulumtimi	Nuk ka			
		Çështjet që ndërlidhen me OBT-në	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
		Industria dhe NVM-të				
		Bujqësia dhe peshkimi				
		Ambienti				
		Politikat e transportit				
		Energjia				
		Shoqëria informatike dhe mediat				

	Kontrolli finansiar				
	Statistikat				
Drejtësia, liria dhe siguria	Vizat, menaxhimi i kufinjëve, azili dhe migrimi				
	Shpërlarja e parave				Red
	Narkotikët			Red	
	Policia	Green			
	Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit				
	Mbrojtja e të dhënavë personale	Red			

Kryesore:

Nuk ka përparim/ shqetësimet serioze / zhvillimet shqetësuese	Red
Pak/e kufizuar/përparim shumë i kufizuar	Orange
Pak përparim	Yellow
Përparim/përparim i madhë	Green

¹ Dokumenti i stafit të punës së Komisionit: Kosova nën UNSCR 12/4499 2009 Raporti i Progresit, f.8. Të gjithë referencat e mëposhtme janë nga ky dokument.

- | | | | | |
|-------------------|-------------------|-----------------------|-------------------|-------------------|
| ² f7 | ¹² f21 | ²² f24 | ³² f22 | ⁴² f45 |
| ³ f7 | ¹³ f28 | ²³ f26 | ³³ f44 | ⁴³ f45 |
| ⁴ f11 | ¹⁴ f45 | ²⁴ f30 | ³⁴ f22 | |
| ⁵ f14 | ¹⁵ f47 | ²⁵ f39 | ³⁵ f34 | |
| ⁶ f42 | ¹⁶ f11 | ²⁶ f31 | ³⁶ f23 | |
| ⁷ f45 | ¹⁷ f8 | ²⁷ f31 | ³⁷ f26 | |
| ⁸ f11 | ¹⁸ f26 | ²⁸ f32 | ³⁸ f26 | |
| ⁹ f8 | ¹⁹ f11 | ²⁹ f24 | ³⁹ f44 | |
| ¹⁰ f15 | ²⁰ f10 | ³⁰ f 21-22 | ⁴⁰ f47 | |
| ¹¹ f16 | ²¹ f21 | ³¹ f22 | ⁴¹ f47 | |